



Titulli i projektit

Ngritja e zyrës së informimit qytetar dhe zyra me një ndalesë

Tipi i projektit

Shërbime publike

Vendndodhja e projektit

Bashkia Kukës

Buxheti i paravlerësuar

73,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Gjatë dekadës së fundit, reformat e ndërmara nga qeveria qendrore (për regjistrimin e biznesit, licencave dhe lejeve, për autorizimin, etj.) për të krijuar një ambient miqësor dhe jo burokratik, si për biznesin, ashtu dhe për qytetarët, kanë prekur dhe përfshirë edhe kompetencat e qeverisjes vendore. Tashmë është përparuar në mënyrë të konsiderueshme në drejtim të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe zgjidhjeve të tjera novatore (p.sh.: zyrat me një ndalesë) për ofrimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e brendshëm. Por përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe i zgjidhjeve të reja në qeverisjen vendore është mjaft i kufizuar. Deri më sot, Bashkia Kukës nuk ka mundur të ngrejë një strukturë të tillë, e cila ka si qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Ndaj është e domosdoshme që në Bashkinë e re të Kukësit të ngrihet një zyrë me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, me qëllim që të evitohet humbja e kohës dhe të rritet cilësia e shërbimit. Përbushja e këtij qëllimi do të mundësohej edhe nëpërmjet përzgjedhjes dhe trajnimit të një stafi të specializuar, që do t'i përgjigjej, siç duhet kërkesave dhe problemeve të paraqitura nga qytetarët.

Qëllimi/et specifike të projektit

Të krijohet infrastruktura e nevojshme me qëllim lehtësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve për të shkurtuar kohën e pritjes dhe rritur cilësinë e shërbimit.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- R1: Krijimi i mjediseve fizike moderne të ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve
- R3: Menaxhim i përmirësuar i proceseve të punës dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit
- R4: Instalimi i një sistemi të integruar të informimit dhe komunikimit me publikun

Zyra me një ndalesë do t'i shërbejë gjithë qytetarëve të Zonës Funksionale.

Nga ndërhyrja do të përfitojë Bashkia e Kukësit, e cila me reformën e re territoriale do të jetë edhe struktura qendrore në ZF.

PROJEKTI 12



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

1. Zhvillimi i projektit të detajuar për punimet e rehabilitimit dhe ndërtimit të ambienteve fizike
2. Punimet për rehabilitimin fizik të ambienteve ekzistuese
3. Pajisja me kompjutera dhe pajisje zyre
4. Instalimi i programeve software për komunikimin e integruar
5. Trajnime të ndryshme për stafin e bashkisë dhe zyrën me një ndalesë
6. Prodhimi i materialeve informuese: fletëpalosje, guida etj.

Maturimi i projektit

Ekziston projekt ideja e zhvilluar nga Bashkia e Kukësit.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Projekti do zbatohet nga Bashkia e Kukësit

Kostot e projektit

Zhvillimi i projektit të ndërhyrjes fizike 3,000€
Punimet për rehabilitimin fizik të ambienteve ekzistuese 30,000€
Pajisja me kompjutera dhe pajisje zyre 10,000€
Instalimi i programeve software për komunikimin e integruar 5,000€
Trajnime të ndryshme për stafin e bashkisë dhe ZIN 20,000€
Prodhimi i materialeve informuese: fletëpalosje, guida, etj. 5,000€